



Datë: 18.07.2025
Numër Protokolli: 4924/2025

A.nr. 984/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj – Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 984/2025, të datës 28.05.2025, të parashtruar nga ankuesi A.M, me përfaqësues të autorizuar avokatë Ilire Tasholli- Aydogan, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “*Ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr. 984/2025, të datës 28.05.2025, të parashtruar nga ankuesi A.M.

II. Mbetet në fuqi, Vendimi me numër 12-104-02-11056-25, i datës 25.04.2025, i Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Obiliqit.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil A.M, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi) me datë 23.05.2025, përmes postës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është pranuar me datën 28.05.2025, nën shenjen A. Nr. 984/2025, kundër Vendimit me numër 12-104-02-11056-25, i datës 25.04.2025, të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Obiliqit, lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 02.06.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa kjo e fundit, më datë 09.06.2025 ka përcjellë shkresat e lëndës lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.Nr. 3556/2025 të datës 28.05.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi nga A. M, për I.T; Vendimi me numër 12-104-0211056-25, i datës 25.04.2025, i Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Obiliqit; Aktgjykimi PKR .Nr. 35/2025, i datës 03.03.2025, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Krime të Rënda”; Zarfi i Postës së Kosovës; Kërkese për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2025, dërguar nga R.K, për A.M; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 984/2025, e datës 09.06.2025; Emalin i datës 31.12.2024, dërguar nga M.G, për A.M; Emalin i datës 31.12.2024, dërguar nga E.S, për A.M; Vendimi me numër protokolli 12-110-03-118-25, i Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Obiliqit; Akt Emërimi me numër protokolli 38, i datës 08.07.2020; Akt Emërimi me numër protokolli 124, i datës 15.08.2019; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Asistent Administrativ në Palestrën Sportive”;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, sepse: Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli Nr. 124 të datës 15.08.2019, është i punësuar në pozitën “ Asistent Administrativ në Palestrën Sportive”, në Drejtoria për Kulturës Rini dhe Sport, në Komunën e Obiliqit.

Tutje Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit përmes vendimit me numër 12-104-02-11056, të datës 25.04.2025, ankuesit i ka përfunduar marrëdhënien e punës në Shërbimin Civil dhe se marrëdhënia e punës përfundon me datë 01.05.2025, me arsyetimin së Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ankuesen e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me vendim të formës së prerë.

Ankuesi A.M, i pakënaqur me vendimin me numër protokolli 12-104-02-11056, të datës 25.04.2025, të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Obiliqit, me datë 28.05.2025 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër vendimit me numër12-104-02-11056, të datës 25.04.2025, të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Obiliqit, me pretendimet ankimore se edhe përkundër faktit së nëpunësi civil është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Prishtinë, (dhe se në kohen e shpalljes fajtor ka qenë në marrëdhënie punë Komunën e Fushë Kosovës pretendon avokati, por në dukje kjo është gabim teknik, sepse nga shkresat e lëndës nuk figuron asnjë dokument nga komuna e Fushë Kosovës) ndërsa që largimin nga puna është lëshuar nga Komuna e Obiliqit, ku parashihet së marrëdhënia e punës përfundon kur nëpunësi civil shpallet fajtor me vendim të formës së prerë, mirëpo Komuna e Obiliqit ka marrë si të mirëqenë këtë dispozitë ligjore pa u lëshuar në analizën e rrethanave lehtësues, fillimisht atë që Gjykata nuk e konsideron si të rrezikshme pasi që edhe përkundër mundësive ligjore nuk i beri asnjë ndalesë për të ushtruar funksionin publik dhe se vendimi për largim nga puna është marrë automatikisht dhe pa vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe pa një analizë të ndikimit të veprës penale në pozitën e tije aktuale.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, analizoi legjislacionin e aplikueshëm për nëpunësit civil, në kohen e nxjerrjes se aktit të kontestuar, gjegjësisht Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht:

Nenin 37 [Marrëdhënia e punës në shërbimin civil], paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj.

Nenin 73 [Përfundimi në rastet e caktuara nga ligji] paragrafin 1, ku përcaktohet se: 1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon për rastet e përcaktuara në ligj, kur: 1.1. nëpunësja/i vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij; 1.2. nëpunësja/i humb shtetësinë, kur ajo kërkohet; 1.3. kur merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar; 1.4. mbushet mosha për pensionim sipas Ligjit të Punës; 1.5. konstatohet paligjshmëria e aktit të emërimit; 1.6. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.

Kolegji i Këshillit, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, po ashtu ka analizuar aktin e goditur me ankesë, gjegjësisht Vendimin numër protokolli 12-104-02-11056, të datës 25.04.2025, me të cilin ankueses i është përfunduar marrëdhënia e punës, dhe si rrjedhojë ka gjetur se i njëjti është nxjerrë mbi bazën e dispozitave të nenit 73 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, për arsye se sipas Aktgjykimit PKP.Nr.35/22 të datës 03.03.2025, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ankuesi për shkak të veprës penale ndihma në kryejnë e veprës penale konflikt i interesit, është dënuar me shumen totale prej 5000, pesë mi euro, me të cilin dënim është e obliguar ta paguaj që në afatin prej 15 ditësh, i cili Aktgjykimi ka marr formën e prerë me datën 14.04.2025, sipas vulës së plotfuqishmërisë të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Andaj, nisur nga fakti se ndaj ankuesit i është shqiptuar dënim për shkak të veprës penale ndihma në kryejnë e veprës penale konflikt i interesit, është dënuar me shumen totale prej 5000€, me të cilin dënim është i obliguar që të paguaj në afatin prej 15 ditësh, Kolegji i Këshillit konstaton se përfundimi i marrëdhënies së punës ankuesit është bërë në përputhje me ligjin material, ngase dënimi me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, në këtë rast ankuesi për kryerje të veprës penale me dashje, përbën shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës, sipas dispozitave të nenit 73 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe se mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se vendimi i kundërshtuar me ankesë është i ligjshëm, në kuptim të nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe për rrjedhojë pretendimet ankimore të ankuesit nuk qëndrojnë dhe si të tilla janë të pa bazuara. Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr 984/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësues së autorizuar të ankuesit avokates Ilire Tasholli- Aydogan ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së